



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:005227

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05747767

**C-III - 15- 0391**

**Paditës:** Z M nga Prizreni me banim në Beograd , i përfaqësuar nga avokati N K nga Prizreni.

**Kundër**

**Të paditurit:** 1) NSH „, Dushanova Grad ” Prizren .

2) NN „Ramiz Sadiku” Prizren të dyja të përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, në Prishtinë, rr. „Driton Hoxha ” 55, përfaqësuar nga Përparim Gashi .

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Specializuar, i përberë nga Gjyqtari Kryesues Hasim Sogojeva dhe Gjyqtarët anëtar Asllan Krasniqi dhe Sylejman Shumolli, pas mbajtës së seancës dëgjimore publike, më dt. 22 prill 2024 , me shumicë votash, më dt. 17 maj 2024, mori këtë :

**A K T G J Y K I M  
PËR MOSPARAQITJE**

- I. HEDHET padia e paditësit Z M kundër të paditurave NSH „Dushanova Grad ” dhe NN „Ramiz Sadiku ”, që soliadrisht të paguajnë në emër të dëmit për shkak të pamundësisë së shfrytëzimit të shtëpisë në Prizren , Rr. D. T nr., për periudhën prej dt. 01.10.1989 deri më dt. 01.04.1998, nga 1,000DM për çdo muaj .**
- II. Secila palë i heqë shpenzimet e procedurës .**

**Rrethanat Faktike dhe Procedurale**

Me dt. 11.05.1998, është ushtruar padia e paditësit përmes avokatit I C kundër të paditurave për kompensimin e dëmit në pronë, që ka pasur shenjë C. nr. 473/98, në Gjykatën Komonale në Prizren.

Në padi ka theksuar se me Aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Komonale në Prizren, C. nr. 1228.91, dt. 16.06.1992, të paditurat janë obliguar që solidarisht që ta kthejnë në gjendje të mëparshme objektin e shtëpisë që gjendet në Prizren, D. T, nr., ose të paguajnë shumën e dëmit të shkaktuar, në lartësi 11,547.678 dinar .

Paditësi ka theksuar, pasi shtëpia nuk është kthyer në gjendje të mëparshme për më shumë se 6 vite, por dëmi total me rastin e prishjes së objektit të hotelit „Turist”, dt. 18.09.1989, ishte caktuar dhe gjykuar, paditësi ka ushtruar propozim kundër të paditurave për përmbarim të dhunshëm E. Nr. 12709/92, dhe paditësit ju është paguar shuma në emër të dëmit në prill të vitit 1998, Paditësit përveç dëmit të drejtë për drejt ka pësuar edhe dëm për shkak të mos shfrytëzimit të shtëpisë gjatë periudhës derisa nuk është kompensuar në procedurë përmbarimore gjyqësore . Paditësi ka të drejtë në kompensimin e tërësishëm të dëmit sipas nenit 266 të LMD-së dhe ka fituar të drejtën për kompensimin e dëmit sipas nenit 278 të këtij ligji, pasi ju është shembur objekti me 6 njësi dhe podrum, me magazina , hapsira me infrastrukturë komplet, ndërsa shtëpia disa katëshe ishte në pjesën e qyteti të vjetër në Prizren, dhe përherë ka pasur klient, të cilën e ka dhënë me qira, në dy kate , dhe vlerëson se ka mundur të realizojë të hyra mujore në shumën 1,000DM.

Ka bashkangjitur :

- Aktgjykimin C. nr. 1228/91, i formës së prerë më dt. 17.09.1992 .

Më dt. 15.01.2015, Gjykata Themelore në Prizren me Aktvendimin C. nr. 348/2013, është shpallur jo kompetente .

Më dt. 04.05.2015, AKP-ja, përmes përfaqësuesit të saj ka dorëzuar parashtrësën në mbrojtje me të cilën ke kundërshtuar kërkesëpadinë paditësit. Me parashtrësë është deklaruar se NSh „Ramiz Sadiku” është në procedurë të likuidimit prej dt. 11.11.2006, dhe paditësi kishte dorëzuar kërkesë kreditore, e cila është refuzuar me Vendimin PRZ 017- 0045 .

Ka kërkuar të refuzohet kërkesëpadia .

Më dt. 31.05.2015, DHPGJS ka lëshuar Urdhër për paditësin me të cilin ka kërkuar që të deklarohet në parashtrësë të mbrojtjes, tentimi për dorëzim është bërë, më dt. 04.06.2018, por ka dështuar, për shkak të adresës .

Më dt. 31.08.2022, DHPGJS, ka lëshuar Urdhër për paditësin C- III- 15- 0391, me të cilin ju është kërkuar nga paditësi të plotëson padinë e tij në lidhje me kompensimin e dëmit, duke bërë sigurimin e provave, pastaj ju është kërkuar të jep përgjigje në parashtrësë të AKP-së, dt. 04.05.2018, dhe të caktoj një person të autorizuar në territorin e Republikës së Kosovës për pranimin e dërgesave, nga Gjykata. Paditësi është njoftuar edhe për pasojën juridike për mos dorëzim të provave .

Më dt. 13.09.2022, dhe 06.10.2022, paditësit ju është dorëzuar Urdhri në adresën e tij të banimit në Beograd.

Më dt. 19.10.2022, avokati N K nga Prizreni dorëzoi parashtrësën me të cilën ka deponuar autorizimin për përfaqësim të paditësit, dhe me këtë parashtrësë ka dorëzuar :

- Autorizimin e përpiluar nga avokati S D M dt. 10.10.2022,
- Kopjen e Aktgjykimit C. nr. 1228/91, të Gjykatës Komunale në Prizren,
- Certifikatën për njësinë kadastrale P- ..., dt....,
- Kopjen e planit dt. 29.05.1996,
- Tipologjia e objektit ndërtimor,
- Njoftimi i lëshuar nga drejtori i „Ramiz Sadikut” dt. 21.09.1989,

- Dokumenti për të dhënat e sipërfaqes së tokës, bruto ndërtimi i objektit, hapësira e shfrytëzimit të objektit ,
- Objekti neto,
- Ekspertiza e ekspertit,
- Ekspertiza dt...,
- Procesverbali për inspektim të objektit të hartuar nga Komuna Prizren,
- Aktvendimi për ekzekutim i Gjykatës Komunale në Prizren dt. 04.03.1998,

Më dt.14.09.2022, AKP-ja ka dorëzuar parashtresën me të cilën është deklaruar në lidhje me padinë e paditësit, dhe ka theksuar se në procedurën e likuidimit, ka pasur kërkesë nga paditësi ndaj NSH „ Ramiz Sadikut ” dhe është refuzuar kërkesa me Vendimin PRZ 017- 0045, dhe kundër këtij vendimi nuk ka pasur ankesë, ka kërkuar të hedhet padia e paditësit .

Më dt. 14.02.2024, DHPGJS, ka lëshuar njoftimin për palët ndërgjyqës, me të cilin janë njoftuar se gjykata ka caktuar seancë dëgjimore publike për dt. 22.04.2024, në ora 9,30h, sikundër që palëve ju është kërkuar për racionalizim të procedurës dhe kohës të japin pikëpamjet shitesë në lidhje me çështjen juridike . Me njoftim palët janë informuar edhe për pasojën juridike të mungesës sipas nenit 58 të Ligjit nr. 06/L-086.

Më dt. 08.03.2024 avokati N Ke ka pranuar njoftimin , ndërsa AKP-ja më dt. 01.03.2024.

Më dt. 18 04.2024 , avokati N K ka dorëzuar një parashtresë me të cilën ka pohuar faktin se ka pranuar njoftimin për mbajtje të seancës dëgjimore publike , sikundër ka theksuar se nuk ka pasur mundësi me kontaktuar me paditësin pasi ai jeton në Republikën e Serbisë, dhe nuk ka mundur të kontaktoi , ka kërkuar shtyrje të seancës dëgjimore, përkundër faktit se ai është njoftuar se gjykata do të mbaj vetëm një seancë dëgjimore dhe pasojën juridike të mos prezencës.

Më dt. 22.04.2024, është mbajtur seanca dëgjimore publike në të cilën nuk ka prezantuar avokati N K ndërsa për të paditurin AKP, ka prezantuar përfaqësuesi me autorizim P G.

AKP-ja, përfaqësuesi i saj në seancë dëgjimore, ka kërkuar që të refuzohet kërkesa e avokatit për të shtyrë seancën dëgjimore publike, sepse nuk ka arsye për shtyrje .

Kolegji i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, me aktvendim procedural ka refuzuar propozimin për shtyrje të seancë dëgjimore publike .

Përfaqësuesi i AKP-së, kërkoi të merret Aktgjykim për mosparaqitje .

### **Arsyetimi Ligjor**

#### **Ankesa e paditësve hedhet .**

Me nenin 58 të Ligjit nr. 06/L-086, është paraparë ,, 1. Nëse pala kundërshtare, të cilës i është dorëzuar kërkesa, nuk paraqitet në seancë dëgjimore për të cilën është njoftuar sipas rregullit dhe me kohë, atëherë gjyqtari(ët) gjegjës, sipas detyrës zyrtare, apo në bazë të kërkesës së Parashtruesit, mund të nxjerrë një Aktgjykim për mosparaqitje kundër palës kundërshtare. 2. Nëse parashtrues i ftuar sipas rregullit nuk paraqitet në seancë dëgjimore apo nëse braktis procedurat, atëherë gjyqtari(ët) gjegjës mund, pas parashtrimit të kërkesës nga pala kundërshtare, të nxjerrë një Aktgjykim për mosparaqitje kundër Parashtruesit duke hedhur poshtë kërkesën dhe

duke urdhëruar Parashtruesin që të paguajë të gjitha shpenzimet procedurale. 3. Para nxjerrjes së një aktgjykimi për mosparaqitje, gjyqtari(ët) gjegjësisht vlerëson se janë përmbushur të gjitha këto kushte: 3.1. kërkesa është e pranueshme; 3.2. faktet e pretenduara nga Parashtruesi mbështesin kërkesën;

Gjykata vlerëson se në rastin konkret, paditësi/ avokati ishte ftuar në mënyrë të rregullt, për seancën dëgjimore publike të caktuar, më dt. 22.04.2024, pasi njoftimin për mbajtjen e seancës dëgjimore, e ka pranuar më dt. 08.03.2024, gjegjësisht 44 ditë para caktimit të seancës dëgjimore publike, dhe se avokati ka pasur kohë të mjaftueshme, për tu konsultuar me autorizim -dhënësin e tij, dhe se për këtë arsye me aktvendim procedurë është refuzuar kërkesa për shtyrje të seancës, pastaj nga data kur paditësi e ka pranuar Urdhrin, e lëshuar nga Gjykata dt. 31.08.2022, të cilin paditësi e pranoi më dt. 13.09.2022, e deri kur është caktuar seanca dëgjimore ka kaluar koha më shumë se një vit e gjysmë, do të thotë ka pasur kohë të mjaftueshëm për tu përgatitur dhe kohë për të prezantuar në seancë avokati i tij.

Me njoftim për mbajtje të seancës dëgjimore publike, avokati N K është njoftuar edhe për pasojën juridike për mos prezencë, që parasheh neni 58 të Ligjit nr. 06/L-086.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret janë përmbushur të gjitha kriteret e parapara për marrjen e Aktgjykimit për mosparaqitje sipas neni 58, paragrafi 3, lidhur me paragrafin 2, të Ligjit nr. 06/L-086, pasi paditësi e ka pranuar njoftimin për mbajtje të seancës dëgjimore për 22. 04. 2024, ndërsa nuk ka prezantuar .

### **Shpenzimet Gjyqësore:**

Në bazë të neni 62 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, u vendos që secila palë ti heqë shpenzimet e veta të procedurës .

### **Këshillë Juridike:**

Kundër këtij aktgjykimi, sipas neni 59, të Ligjit nr. 06/L-086, mund të ushtrohet kërkesë për prishje të aktgjykimit për mosparaqitje në afatin prej një muaj dite, Kërkesa i dorëzohet Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme dhe palës kundërshtare / të paditur.

Hasim Sogojeva, Gjyqtar kryesues

Asllan Krasniqi Gjyqtar anëtarë

Sylejman Shumolli Gjyqtar anëtarë